


Pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak dhe Të Prefekturës , hapen aplikimet për programin “SUBVENCIONI I INTERESAVE TE KREDISE”

Të cilat do të jenë në dy faza. E para realizohet përmes portalit qeveritar “eAlbania” brenda 30 ditëve kalendarike nga data 22.01.2025 deri me date 21 02.2025. Në portal, qytetarët duhet të aplikojnë duke zgjedhur shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social”.

Vetëm ata që kalojnë me sukses fazën e parë, duhet të depozitojnë pranë zyrave të Bashkisë Rrogozhinë , formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin “e-Albania”. Kjo duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar. Në lidhje me këto të fundit, të vlefshme do të konsiderohen dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente jo më herët se 3 muajt e fundit.

Individi/ familja që ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi për strehimin social dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, i hiqet e drejta për të përfituar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin ,Drejtorja e Mbrojtjes dhe Shërbimit Social!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 83 Prot.

Rrogozhinë, më 23.12.2024

VENDIM

Nr. 60 , datë 23. 12. 2024

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 23.12.2024 mori në shqyrtim projektvendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5172/1.Prot datë 13.12.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i interesave të kredisë’ “, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5172/2.Prot datë 13.12.2024.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , i ndryshuar , Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” neni 16, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” VKM Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njesive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njesive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Me 14 (katërmëdhjetë) vota pro, 1 (një) votë kundër dhe 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për programin, “Subvencionimi i interesave të kredisë” për familjet e pastreha si më poshtë vijon tabela:

Nr	Kriteret e pikëzimit	Pikët
1.1	<i>Kushtet e strehimit</i>	18
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi	3
B	Familja banon në banesë me rrezik shembjeje	3
C	Familja banon në banesë me një numër të madh pjesëtarësh nën normat e strehimit	3
Ç	Familjet të cilat kanë ngelur të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore	3
D	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
E	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike	3

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



1.2	<i>Kushtet familjare</i>	25
A	Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përshihen edhe vajzat nëna	8
B	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	5
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	7
Ç	Bashkëshortët moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç	5
1.3	<i>Kushtet sociale</i>	32
A	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.	2
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç.	2
C	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve	2
Ç	Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit	2
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë	2
E	Punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH)	2
F	Punonjësit e repartit RENE A	2
G	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	2
H	Viktimat e dhunës në familje	3
I	Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	2
J	Anëtarët e komunitetit rom	3
K	Anëtarë të komuniteti egjiptian	3
L	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur, pas ekzekutimit të dënimit	1
M	Vajzat nëna	3
N	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi	1
1.4	<i>Kushtet ekonomike</i>	25
A	Familje me të ardhura mesatare, që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 % e të ardhurave mesatare	10
B	Familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 % e të ardhurave mesatare	5
C	Familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70% e të ardhurave mesatare	5
Ç	Familje pa të ardhura, që janë familje me ndihmë ekonomike, si dhe ato që përveç ndihmës ekonomike përfitojnë pagesat sipas paragrafit të dytë të pikës 44 të këtij neni.	5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social dhe Komisioni për Programet e Strehimit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT

ERIND TOSKU

